



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-2329/24  
Kaçanik, 31.01.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 janar 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsye 2 anëtarë: Florina Lika-Vishi dhe Betim Shala, në ndërkohë 7 anëtarë nga LVV e bojkotuan mbledhjen në të gjitha pikët: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive (09) morën pjesë në mbledhje apo në pjesë të mbledhjes, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 25 anëtarë, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hap mbledhjen e I (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, data 31 janar, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;
3. Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023;
4. Plani Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024;
5. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;
6. Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023;
7. Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut;
8. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri;
9. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi;
10. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli;

11. Propozim Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut;
12. Njoftim me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T – DIAP për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

**z. Agim Mani:** Para se me miratuar rendin e punës, mendoj që pyetjet të cilat i kemi bërë, nuk janë adresuar në mënyrë adekuate ashtu siç i kemi adresuar. Përgjigjet duhet të epën ashtu siç i kemi bërë pyetjet. Përgjigjet duhet të epën kryesisht nga dikasteri që i drejtohem. Pyetja e cila i është adresuar Kryetarit të Komunës, përgjigja na është dhënë nga Drejtori i Urbanizmit. Përgjigja në pyetjen e adresuar, është dashur të jetë nga Kryetari i Komunës ose nga Zyra e Kryetarit. Në këtë rast Kryetari i Komunës dhe Zyra e Kryetarit nuk kanë dhënë përgjigje. Besoj se Kryetari i Komunës, Zyra e Kryetarit edhe Ekzekutivi në përgjithësi, duhet të jenë me serioz ndaj përgjigjeve në pyetjet të cilat i bëjmë ne. Në të kundërtën, nëse vazhdoni në këtë formë, po tregoni jo seriozitet si Ekzekutiv dhe si Kryetar, ne nuk mundemi me marrë qëndruar në mbledhje. Për këtë arsye e bojkotojmë mbledhjen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është çështje e juaja, mirë është mirë është me qenë pjesë e seancës, sido që të jetë, është vendimi i juaj dhe ne e miratojmë vendimin e juaj.

Me këtë rast, shtatë (7) anëtarët nga Lëvizja Vetëvendosje- LVV i bojkotuan punimet e mbledhjes në të gjitha pikët: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit Kemal Murseli theksoj se: Është për keqardhje lëshimi i seancës pa arsye, kryetari sigurisht ka me thënë diçka me thënë. Fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi:** Unë e pash të paarsyeshme lëshimin e mbledhjes se anëtarëve nga LVV, për arsyet që i theksuan. Drejtorët e drejtorive janë njëherë edhe këshilltarë të kryetarit. Unë nuk e di çfarë përgjigje duhet me iu dhënë, kur kanë kërkuar a janë marrë masa ndaj drejtorit. Drejtori i Urbanizmit e ka sqaruar se nuk janë marrë masa me arsyetimin të cilin e kanë pasur paraprakisht. Unë nuk e di çfarë përgjigje me të qartë duhet me iu dhënë. Sipas tyre me e arsyeshme qenka me ia kthyer përgjigjen një këshilltar nga Zyra e Kryetarit sesa nga këshilltari të cilin e kam emëruar vet unë drejtor të drejtorisë përkatëse. Mua me është dukur e paarsyeshme kjo formë e tyre e aplikuar. Kjo po tregon se ata anëtarë të LVV nuk paskan me marrë pjesë në asnjë mbledhje deri në përfundim të mandatit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me bojkotimin e seancës nga anëtarët e sipër cekur, në sallë janë 18 anëtarë Prezentë. Kuorumi ekziston, seanca vazhdoj me punimet e mbledhjes. A ka kush diçka rreth rendit të punës. Për diskutim nuk u paraqit kush tjetër, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### APROVOJ

**Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni: Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

#### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë ) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 28.12.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-32521/23.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** Me keqardhje po e nis këtë vit duke vene kritikën fillimisht tek ju kryetar.

1. Si është e mundur dhe pse gjatë përfundimit të vitit 2023 nuk gjetet kohë e nuk morët as mund të ndani se paku mirënjohje për individ, organizata, apo klube sporti për kontributin në shoqëri. Vlerësimi nga institucioni do të shërbente si motivim shtese për punën dhe sjelljen e rezultateve në shoqëri. Kjo përveç kritikës le të jetë edhe thirrje që neglizhenca e tillë të mos krijohet në shprehë, ngase nuk ju shërben as juve si institucion po as qytetarëve si motiv.

2. Me datë 25 Janar, keni hapur konkursin për përfitim të bursave studentore, vlera e të cilëve është 50 euro për 10 muaj. Në kriteret e përcaktuara në Rregulloren nr06/2016 për kushtet e kriteret, dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve në nenin 15 i epët e drejtë ekskluzive vendimit të kryetarit ,konkretisht pikën 1.2 për numrin e përfituesve të bursave në një familje, vendim të cilin e kam të pamundur të e gjej në faqen zyrtare, e për ne e vetmja mundësi informimi mbetet faqja e komunës, e do të thotë në të nuk figuron-ku është transparenca. Gjithsesi, nëse këtë vit nuk ndërmerren hapat të heqjes së kryetarit të ndarjes së vetëm një përfituesi student në familje nga bursa, ngase vështirësitë financiare janë me të mëdha për ato familje që kanë dy apo me shumë fëmijë në studime, pavarësisht shumëve të vogël të subvencionit po besoj do të lehtësonte dhe stimulonte studentët do të propozoja që ky kriter të hiqej që nga viti i ardhshëm, dhe shpresoj që së paku në këtë pikë të gjejë përkrahjen e secilit nga ju kolegë asambleistë.

3. Shqetësim tjetër që lidhet direkt me jetën e qytetarëve, dhe sidomos në kohë dimri kur numri i tyre është tejet me i madh dhe shqetësues, janë qentë endacak. Po i rikthehem vitit 2022 kur kam ngritur si shqetësim prezencën e madhe të qenve endacak në rryet lokale. Çfarë mase mund të ndikojë për zvogëlimin e numrit të qenve në rrugë?

**znj. Fitore Vishi:** Nga disa qytetarë banues në rrugën "Jehona Raka" me është thënë se ajo rrugë përveç që është tepër e ngushtë, mungon kanalizimi i ujërave atmosferike, gjë që e vështirëson qarkullimin e normal gjatë të reshurave dhe shkakton edhe problem në infrastrukturën e tyre rrugore, si rrëshqitja e dheut. Kërkoj kjo çështje të shqyrtohet dhe të gjenden mundësi buxhetore për përfshirjen e kësaj rruge, në planifikim e punës në mirëmbajtjen e infrastrukturës.

**z. Agim Çaka:** Unë këtë herë e kam një pyetje shumë të lehtë, pasi për pyetjet e vështira ose nuk po kanë përgjigje adekuate, se nuk po janë përgjigje që ne po i kërkojmë, pastaj po hapet debat dhe po vjen deri të problemi, si u paraqit në këtë mbledhje.

1. Pyetja ime ka të bëjë me një dru dekorativ të hyrja e Gjinnazit, ai dru është dëmtuar me qëllim apo pa qëllim, druri qëndron i shtrirë ka kohë, me tepër se një vit. Kjo bien në sy për të keq për ndonjë mysafirë apo vizitor, dhe kjo tregon një moskujdesje të ekzekutivit dhe të gjithëve në përgjithësi. Kërkoj me marrë veprime të nevojshme për rregullimin e kësaj çështje.

**z. Selajdin Troni:** Unë e kam një kërkesë nga lagjja Trupi. Banorët e kësaj lagjeje e kanë adresuar një kërkesë të komuna -DSHPE, për vendosjen e mbrojtësve anësorëve, sepse kjo rrugë paraqet rrezik të madh për banorët e kësaj lagjeje, pasi që nga degëzimi i rrugës” Izahir Troni- deri të kjo lagje, është një lartësi shumë e madhe dhe banorët gjatë lëvizjes me mjetet e tyre motorike, i ekspozohen një rreziku të madh nga rrëshqitja dhe rënia në humnerë. Pothuajse gatë sezonit të dimrit, ajo rrugë është bërë e pamundur, andaj kërkojnë nga DSHPE të merr masa deri sa nuk ka ardhur deri të ndonjë aksident që mund të jetë edhe me fatalitet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje të tjera nuk ka, besoj se shënimet i kanë marrë ekzekutivi, atëherë kalojmë në pikën vijuese;

2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Plani është diskutuar edhe në KPF, kryetari nuk ka qenë prezentë, besoj se nënkryetari ua ka përcjellë vërejtjet tona. Plani është i njëjtë nga viti i kaluar, plani është voluminoz, por aty janë përfshirë edhe disa pika të cilat i keni paraparë ju si aktivitete. Aktivitet nuk është bashkëpunimi ndërkomunal, thellimi i transparencës, bashkëpunimi me asociacionin e komunave, bashkëpunimi i ngushtë me nivelet qendrore, pasi që këto janë detyrime. Për mua aktivitet është koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm, kurse këto të paraqitura si në plan, janë detyrime. Plani është i ekzekutivit, ne nuk mundem me ndërhyrë, se tek e fundit këto janë premtimet e juaja, gjatë fushatës, kështu që ju i keni planet në harmoni me programet e juaja se ku keni menduar me investuar. Uroj të realizohen objektivat, që janë në interes të qytetarëve.

**z. Selajdin Troni:** Unë kam një pyetje për z. Ekrem Livoreka: A ka bërë ndonjëherë ndonjë pyetje të drejtori apo diku tjetër për mos kompensimin e anëtarit Arben Thaqi në Komitetin për Komunitete, nga OJQ/ shoqëria civile, pasi i njëjti që 2 vite nuk paguhet, kompensimi është edhe obligim moral dhe komunat tjera paguhet?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pasi u ngrit si pyetje, mundet me dhënë përgjigje Ekremi, megjithëse kjo pyetje është jashtë rendit të punës.

**z. Ekrem Livoreka:** Pyetja është me vend. Ne kemi kërkuar të drejtori i financave me iu bërë kompensimi Arben Thaqit. Sipas informacioneve që kemi, pagesa ka me iu bërë në muajin shkurt

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa për informacion, çdo mbledhje të Komitetit për Komunitete që mbahet, raportin e pjesëmarrjes së anëtarëve e nënshkruaj unë, dhe i njëjti i dërgohet DBF. Çështja a paguhet apo jo, është çështje e ekzekutivit. Listat nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrjes, ndërkaq shkresën për pjesëmarrje e nënshkruaj unë dhe i dërgohet drejtorisë për ekzekutim. Besoj se problemet të cilat kanë ekzistuar me herët, tani janë sqaruar.

**z. Bahri Selimi:** Është Zyrtari Kryesor Financiar që është me përgjegjës për këtë çështje. Ne së pari duhet shikuar a është e drejtë ligjore, pastaj a është në obligim moral, sepse ne nuk ndajmë mjete në obligim moral, por në obligim të ligjit.

**z. Selajdin Troni:** A mundet me funksionuar Komiteti për Komunitete pa një anëtarë të shoqërisë civile?

**z. Bahri Selimi:** Çështja është se anëtari nga shoqëria civile merr pagë të rregullt në një institucion shtetëror, dhe derisa nuk e kryejnë ministria kompensimin, ne nuk mundemi me ditur a është e ligjshme apo jo.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024 ishte sa për njoftim. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

#### NJOFTOHET

**Me Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024/ Lënda: 01Nr.104/02-1816/24.**

3. Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Herëve tjera nuk kemi pasur një raport të tillë, sepse raporti tremujor financiar tetor-dhjetor, është përfshirë në raportin vjetor financiar. Fillimisht i kemi pasur disa tabela, të cilat përdorën për çështje të brendshme të drejtorisë, drejtori ka qenë në pushim, drejtori e ka rregulluar me vonë raportin financiar, se i njëjti është kërkuar edhe në KPF që raporti në KK të jetë si raportet tjera tremujore financiare. raporti TM\$ është bërë për herë të parë, për shkak të transparencës dhe kërkesës së organizatave monitoruese të KK. E hapi diskutimin;

**znj. Ardita Rrahmani:** Ndoshta ka qenë mirë fillimisht me ia kaluar fjalën drejtorit të DBF, sepse raporti në KPF edhe ne e kemi diskutuar se ka qenë ndryshe i punuar nga herët tjera. Për derisa jemi në incizim të drejtpërdrejtë, ndoshta edhe qytetarët kanë interesim me ditur se për çka bëhet fjalë.

**z. Bahri Selimi:** Është raport tremujor i fundit financiar 2023, tani raportin e kemi dërguar të përmirësuar, raporti ka qenë me tepër i përgatitur për ekzekutivit. Tani raporti është thjeshtësuar, janë paraqitur të dhënat financiare të buxhetit me prerje tetor-dhjetor 2023, është bërë me i kuptueshëm për ju. Ky tremujor financiar hynë zakonisht në e raportin vjetor financiar, i cili besoj se do të jetë në shqyrtim në muajin shkurt. Është kërkesë nga organizatat për me u bërë ky raport për hir të transparencës. Në raport janë paraqitur të hyrat, shpenzimet, në një tabelë janë paraqitur për tërë vitin të hyrat veç e veç sipas llojit. Nëse ka pyetje me të veçantë, iu përgjigjem.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti është sa për njoftim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### NJOFTOHET

**Me Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 400/01-2629/24.**

4. Plani Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** KKSB është organ i formuar nga KK, planet dhe raportet e këtij këshilli vijnë në KK. E hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Arovimin e Planit Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024/ Lënda: 01Nr. 60/01-1445/24.**

5. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në raport është paraqitur aktiviteti i KKSB në vitin 2023. E hapi diskutimin;

**znj. Ardita Rrahmani:** Këtë çështje e kemi debatuar edhe në KPF. E kam një pyetje për kryetarin, përderisa ju kryetar e kryesoni këtë këshill, besoj shqetësimi i opozitës iu ka përcjellë

nga nënkryetari i komunës. Sa janë funksionale kamerat e sigurisë dhe kush jep përgjegjësi në rast të mosfunksionimit të tyre? Nga nënkryetari i komunës kemi marrë përgjigje se nuk janë në kompetencë të komunës, por të MPB dhe Policisë së Kosovës. Ju si kryesues i këtij këshilli na tregoni: Çka po ndodhë me kamerat e sigurisë, a janë në funksionale?

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Nënkryetari ka dhënë përgjigje, atë përgjigje besoj se e japim edhe tani që e potencove. Para 2 viteve ka qenë një vendim i MPB i kemi pasur mjetet e buxhetit të komunës, një pjesë të monitorimit bashkë e kemi bërë ne si komunë në bashkëpunim me policinë, pjesën tjetër e ka pasur vetëm policia prej një donacioni të organizatave tjera. Vendimi i ministrisë që na ka ardhur ka qenë i prerë, se monitorimin e kamerave ka të drejtë të bëjë vetëm policia dhe është kaluar si aset i policisë në nivel lokal. Nga ai moment ne nuk kemi qasje sesi funksionojnë kamerat, është ngritur si shqetësim nga komandanti, ndërkaq formën si me i mirëmbajte ata, e kemi pasi si problem nga zyra e prokurimit dhe zyra e auditorit, ne mundemi me bërë mirëmbajtjen e tyre, por është një lloj shkelje. Unë kam kërkuar me shkresë që MPB të na njofton me shkrim për mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë, që t'na delegon mirëmbajtjen ose të gjendet ndonjë formë që nga auditimi mos të evidentohet si shkelje. Përgjigje nuk kemi pasur, se kamerat e sigurisë janë aset i tyre. Unë kam menduar të bëjmë një planifikim pasi kemi në gjitha shkollat, për mirëmbajtje të kamerave, edhe pse është shkelje ligjore, për mirëmbajtjen e tyre, kështu mundem me evituar ndonjë defekt, përndryshe sesi menaxhohen e mirëmbahen, ajo është çështje e MPB.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kryetar si përgjegjës i kësaj komune, kishte me qenë mirë, iu sugjeroj të merrni informacion rreth kësaj problematike, sidomos në pikat ku ka grumbuj njerëzish, sepse rastet që ndodhin në territorin e komunës, iu shërben edhe juve edhe qytetarëve.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Pajtohem me mendimin e juaj, për atë kam kërkuar të definohet çështja e mirëmbajtjes e tyre, që të kemi një lloj arsyetimi para prokurimit dhe auditimit. Përgjigje nuk kam deri në këtë moment.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Monitorimi i kamerave ka kaluar në kuadër të policisë apo MPB, mendoj se edhe mirëmbajtja iu takon atyre se çdo mirëmbajtje me ato kamera, kërkon qasje në serverat e tyre. Për atë ata e kanë marrë përsipër mirëmbajtjen e tyre, se mirëmbajtja nuk lejon qasje në server. Nëse kërkohet nga komuna me i mirëmbajte kamerat e sigurisë, besoj se kryetari është i gatshëm me i mirëmbajtur. Diskutime të tjera nuk ka, kjo ishte sa për njoftimin e juaj, kështu që konstatoj se Kuvendi i Komunës

#### NJOFTOHET

**Me Raportin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023/Lënda: 01Nr. 60/01-1440/24.**

6.Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, zyrtarja për punë të KK është munduar me përmbledhë aktivitetin e KK në vija të trasha. E hapi diskutimin:

**z. Rrustem Zenuni:** Sa i përket Informatës për aktivitetin e KK, është hera e parë që është bërë në këtë formë, me tabelat e votimit. Unë vlerësoj një raport të tillë, e përgëzoj stafin e KK për këtë informatë të përgatitur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në Informatë është cekur se planifikimi i vizitës zyrtare në Shqipëri dhe në Malin e Zi, nuk është realizuar, për shkak të procedurave të prokurimit të cilat na kanë zvarritë. Dje na ka ardhur përgjigja pozitive nga OSHP se kontrata e lidhur me kompaninë ka qenë në rregull. Tani nga sot e tutje mund të realizojmë vizitën të cilën e kemi pasur në agjendë. Po planifikojmë për nga fundi i javës vijuese me realizuar vizitën. Paraprakisht duhet me marrë

mendimin e juaj, se mund të keni ndonjë agjendë tjetër, që të jetë për shumicën në kohën e duhur.

**znj. Ardita Rrahmani:** A do të realizohet në ditë vikendi vizita zyrtare, cila do të jetë agjenda?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mendojmë të premtën-dielën, ata preferojnë të enjten të premtën. Agjenda është e njëjtë, nuk mundemi me ndryshuar asgjë, ndërkaq për kohën me duhet të kontaktojmë me komunat për shkak të caktimit të afateve kohore. Nëse ka kush ndonjë ndryshim, na njoftoni me kohë. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se KK e Prezantoj

**Informatën për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023/ Lënda; 01Nr. 104/02-2330/24.**

7. Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtoresha është këtu, emrat janë në Propozim Vendim, për hir të transparencës po i lexojmë: Hajredin Ramajli - jurist dhe arkeolog , Sevdije Shehu - historiane, Ermira Krasniqi - arkeologe , Xhabir Zharku - kryetar i OVL-së në Kaçanik, ish komandant i brigadës, Ilaz Krasniqi - profesor i historisë, Shefket Palloshi – kameraman i luftës dhe pasluftës, Fatmir Qaka – zyrtar pran DKRS. Ky këshill do të punoj për me vënë në funksion muzeun e qytetit deri me formimin e organeve drejtuese të muzeut, të cilat i miraton KK. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 17. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut, në përbërje:**

1. **Hajredin Ramajli - jurist dhe arkeolog**
2. **Sevdije Shehu - historiane**
3. **Ermira Krasniqi - arkeologe**
4. **Xhabir Zharku - kryetar i OVL-së në Kaçanik**
5. **Ilaz Krasniqi - profesor i historisë**
6. **Shefket Palloshi - kameraman**
7. **Fatmir Qaka – zyrtar pran DKRS./ Lënda: 01Nr. 104/02-1905/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pikat 8,9 10 janë të natyrës së njëjtë, është hera e tretë që po i trajtojmë, njëherë për miratim, shfuqizim dhe harmonizim me kërkesat e MAPL, dhe tani Propozimet për miratim. Këto çështje do t'i trajtojmë të veçanta:

8. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim Vendimi është harmonizuar me kërkesat e MAPL. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 16. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri/ Lënda: 01Nr.06-104/021938/24.**

9. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 16. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi/ Lënda: 01Nr.06-104/02-1934/24.**

10. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 16. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli/ Lënda: 01Nr. 06-104/02-1940/24.**

11. Propozim Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, komisionin për emërimin e rrugëve e formon KK. Në gjitha legjislaturat e KK ka pasur komisione të tilla., andaj duhet formohet edhe në këtë legjislaturë. E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** E kam një pyetje lidhur me kërkesat të cilat janë bërë komisionit të kaluar nga disa qytetarë, të cilat kërkesa janë miratuar, por ende nuk janë vendosur shenjat me tabelat me emrat e rrugëve të aprovuara. Çka ka ndodhë me këta emra, sepse nuk mundet me i rënë përgjegjësia komisionit të ri, për një çështje që ka qenë e komisionit të vjetër?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në disa raste MAPL nuk i ka aprovuar disa emërtime të rrugëve për shkak të disa karakteristikave dhe veçorive që i kanë pasur, besoj se ato rrugë me komisionin e ri kanë më qenë edhe njëherë në trajtim. MAPL e di se ka bërë klasifikim se cilat rrugë nuk duhet vazhduar tutje procesi. Komisioni i trajton ato çështje dhe na njofton edhe neve se cilat emërtime nuk kanë qenë në rregull për miratim. Ne jemi duke folur sot vetëm për formimin e komisionit, i cili ka me u marrë me trajtimin e kërkesave dhe ankesave sipas ligjit dhe të njëjtat kanë me u sjellë në KK për miratim. Emërtimet shqyrtohen veç e veç, po ashtu shkojnë në shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete të formimit të komisionit, duke filluar sipas subjekteve politike me të mëdha.

**z. Selajdin Troni:** Nga PDK e propozojmë për anëtar të komisionit Rustem Zenuni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga LVV nuk kemi asnjë anëtarë prezentë. Shkojmë me subjektet tjera politike

**znj. Ardita Rrahmani:** Nga LDK e propozojmë për anëtar të komisionit, Besnik Salihu.

**z. Qamil Stagova:** Nga OJQ, Valon Raka; ndërkaq nga Ekzekutivi: Shkodran Sopa dhe Kaltrina Çaka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet për anëtarë të komisionit i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë;

## VENDIM

Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërimin të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje:

1. Rrustem Zenuni anëtar (PDK)
2. Besnik Salihu anëtar (LDK)
3. Valon Raka anëtar (OJQ/Shoqëria Civile)
4. Shkodran Sopa anëtar (Ekzekutivi)
5. Kaltrina Çaka anëtare (Ekzekutivi)/ Lënda: 01Nr. 104/02-1953/24.

12.Njoftim me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T –DIAP për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni e ka sjellë njoftimin për refuzimin e ofertës, se ka qenë nën çmimin fillestar. Nëse ka kush diçka të urdhëroj. Për me marrë fjalën nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

### NJOFTOHET

**Me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T –DIAP për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-32048/23.**

Për fund, Kryesuesi i Kuvendit theksoj se planifikojmë diku kah dita e enjte, e premte dhe e shtune të realizohet vizita zyrtare në Shqipëri dhe në Malin e Zi.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:46. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 16 anëtarë, 7 anëtarë nga LVV: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma. i bojkotuan punimet e mbledhjes në gjitha pikët, ndërkaq 2 anëtarë dolën me herët nga mbledhja me lejen e Kryesuesit të KK, Raif Kasa gjatë shqyrtimit të pikës 7, Bashkim Krasniqi gjatë shqyrtimit të pikës 8.

Procesmbajtëse  
Makfire Malsiu

*Makfire*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

*Kemal Murseli*

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e I (parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin  
2024, mbajtur me 31.01.2024**

1. Kemal Murseli .....
2. Brahim Imishti.....
3. Hamide Luma .....
4. Kadri Krivenjeva .....
5. Fitore Vishi,.....
6. Rrustem Zenuni,.....
7. Edon Baftiu .....
8. Selajdin Troni .....
9. Fatmir Bunjaku .....
10. Bashkim Krasniqi .....
11. Florina Lika-Vishi .....
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....
13. Agim Mani .....
14. Kadrije Lika-Troni .....
15. Adnan Reka .....
16. Naim Beça .....
17. Raif Kasa .....
18. Ernesta Krasniqi,.....
19. Bashkim Luma .....
20. Arta Avdiu .....
21. Ardita Rrahmani .....
22. Besnik Salihu .....
23. Betim Shala,.....
24. Arlinda Rakoci-Raka.....
25. Rabije Sallahi.....
26. Ekrem Livoreka.....
27. Agim Çaka.....



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

Përgjigje

Për Kuvend respektivisht Asambleistes Ardita Rrahmani  
Pyetja: Lidhur me vendimin dhe konkursin për ndarjen e Bursave?

E Nderuar

Duke u bazuar në rregulloren nr. 06/2016 për kushtet, kriteret dhe ndarjen e subvencioneve, është marrë vendimi i Kryetarit 01.Nr. 670/01-2391/2024 , datë 23.01.2024 për caktimin e kriterëve për ndarjen e bursave, duke u bazuar te Neni 15 pika 1.2 të rregullores **Numri i studentëve në familje**, në vendim është cekur te pika 4 që nga një familje mund të përfitoj vetëm një student i cili ka notën mesatare më të lartë, në konkurs është cekur te pika 2 që nëse janë dy student nga një familje i shtohet 1(një) pikë më shumë, kështu që vendimi dhe konkursi lidhur me bursat është ne harmoni me dispozitat ligjore dhe me kompetencat e Kryetarit. Për ndarjen e bursave në vitin e ardhshëm e shqyrtojmë mundësinë për ndryshimin e Neni 15 pika 1.2.

Vendimi dhe konkursi janë të publikuara në Web-faqen e Komunës së Kaçanikut.

Bashkangjitur keni:

Vendimin e Kryetarit për ndarjen e Bursave i datës 23.01.2024

Konkursin për ndarjen e bursave i datës 25.01.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

**Kryetari i Komunës**  
01.Nr. 670/01-2391 /24  
Kaçanik, 23.01.2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 400/03-24314/23 si dhe nenit 14, 15 të Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### VENDIM

#### Për Ndarjen e Bursave dhe Caktimin Kriterëve për Vitin Akademik 2023-2024

1. Me këtë Vendim caktohen kushtet për aplikim, kriteret e përzgjedhjes, kohëzgjatja e realizimit të bursave, lartësia dhe numri i përfituesve të bursave.
2. Për vitin akademik 2023-2024, Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për student të studimeve themelore universitare, në shumën 50 € në muaj (për 10 muaj).
3. Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kriterë:
  - 3.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
  - 3.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
  - 3.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
  - 3.4 të jenë student të vitit të dytë e me lartë,
  - 3.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
  - 3.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Makineri dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor).
4. Nga një familje mund të përfitoj vetëm një student, ndërsa përfitues do të jetë ai student që ka notën mesatare më të lartë.
5. Studentët të cilët i plotësojnë kriteret nga pika 3 e këtij vendimi, gjatë aplikimit duhet t'i paraqesin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kritereve:

6.1 Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10,

6.2 Studentët e drejtimeve deficitare nga pika 3.6 përfitojnë 5 pikë,

6.3. Studentët të cilët i takojnë kategorive të dala nga lufta (fëmijët e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të luftës), u shtohen 2 pikë,

6.4 Studentët me gjendje të rëndë ekonomike dhe studentë me aftësi të kufizuara, u shtohen 2 pikë dhe

6.5 Dy e më shumë studentë nga një familje, u shtohen 1 pikë.

7. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Drejtoria e Arsimit.

9. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Arkiva.



Kryetari i Komunës;  
Z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

Kryetari i Komunës  
01.Nr. 111/01-2616 2024  
Kaçanik, 25.01.2024

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.400/03-24314/23, Vendimit të Kryetarit të Komunës 01.Nr. 670/01-2391/24 i dt. 23.01.2024 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, shpallë:

### KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

1. Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2023-2024, do të ndan 50 bursa me nga 50 € në muaj (për 10 muaj) për student të rregullt të studimeve themelore.

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
- 1.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
- 1.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
- 1.4 të jenë student të vitit të dytë e me lartë,
- 1.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
- 1.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Makineri dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor.)

2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10 dhe drejtimeve deficitare i shtohen 5 pikë.

Studentët përfitojnë pikë tjera në qoftë se i takojnë këtyre kategorive:

- Është fëmijë i kategorive të dala nga lufta (i dëshmorit, i invalidit, i veteranit, i martirit) -i shtohen 2 pikë,
- Është fëmijë nga familja me gjendje të rëndë ekonomike, person me aftësi të kufizuara, - i shtohen 2 pikë,
- dy e më tepër student të një familje - i shtohen 1 pikë.

3. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- 3.1 kërkesa për bursë,
- 3.2 kopje e dokumentit të identifikimit,
- 3.3 dëshmia e regjistrimit të vitit akademik 2023-24,
- 3.4 certifikata e provimeve të dhëna original dhe kopjen e indeksit,
- 3.5 deklaratë e bashkësisë familjare, ekstraktin e lindjes,
- 3.6 dëshminë se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve,
- 3.7 dëshmi që i takon kategorisë sipas pikës 2.

#### Afati dhe mënyra e aplikimit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Afati për aplikim është 15 ditë pune, nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej 25.01.2024 deri 14.02.2024.

**Vërejte:** Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë.

Prej një familje mund të jetë përfitues vetëm një student.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kaçanik

## Kryetari i Komunës

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ **Znj. Ardita Rrahmani**

Kaçanik, 28/02/2024.

### **Lënda: PËRGJIGJE**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,


E nderuar Znj. Ardita Rrahmani ,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 31/01/2024.

Lidhur me pyetjen tuaj rreth ndarjes së mirënjohjeve për individ, organizata apo klube sportive për vitin 2023, ju njoftojmë se kemi ndarë mirënjohje gjatë tërë vitit 2023 për individ, organizata, klube sportive, dhe sportist të dalluar duke u bazuar në sukseset e tyre të arritura gjatë tërë vitit, gjithashtu sukseset e tyre janë promovuar duke u publikuar edhe në web faqen zyrtare të komunës .

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Besim Ilazi  
  
Kryetar i Komunës



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 23.02.2023

**Për: Anëtarët e Kuvendit- znj. Ardita Rrahmani  
z. Selajdin Troni**

### Lënda: PËRGJIGJE

I nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të japim sqarime zyrtare lidhur me pyetjen/kërkesen tuaj, të parashtruara në mbledhjen Kuvendit të Komunës, më datë, **31.01.2024**, e cila ndërlidhet me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.


**znj. Ardita Rrahmani:** Shqetësim tjetër që lidhet direkt me jetën e qytetarëve, dhe sidomos në kohë dimri kur numri i tyre është tejet me i madh dhe shqetësues, janë qentë endacak. Po i rikthehem vitit 2022 kur kam ngritur si shqetësim prezencën e madhe të qenve endacak ne rrugët lokale. Çfarë mase mund te ndikojë për zvogëlimin e numrit te qenve ne rrugë?

- Prezenca e qenëve endacak në rrugë dhe lokalitete të ndryshme të komunës është shqetësim i vazhdueshëm edhe për ekzekutivin e komunës sonë. Në lidhje më këtë fenomen nga buxheti i drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave u destinuan 19,000.00€ për kontratën në periudhë trevjeçare 2021-2023 dhe u trajtuan rreth 432 qenë në zona të ndryshme të komunës.  
Në nivel vendi ekziston Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Popullacionit të Qenve 2023-2025 ku parashihen hapat efektiv dhe të qëndrueshëm të kontrollit të popullsisë së qenve endacak në Republikën e Kosovës.*

**z. Selajdin Troni:** Unë e kam një kërkesë nga lagjja Trupi. Banorët e kësaj lagjeje e kanë adresuar një kërkesë të komuna -DSHPE, për vendosjen e mbrojtësve anësorëve, sepse kjo rrugë paraqet rrezik të madh për banorët e kësaj lagjeje, pasi që nga degëzimi i rrugës” Izahir Tronideri të kjo lagje, është një lartësi shumë e madhe dhe banorët gjatë lëvizjes me mjetet e tyre motorike, i ekspozohen një rreziku të madh nga rrëshqitja dhe rënia në humnerë. Pothuajse gatë sezonit të dimrit, ajo rrugë është bërë e pamundur, andaj kërkojnë nga DSHPE të merr masa deri sa nuk ka ardhur deri të ndonjë aksident që mund të jetë edhe me fatalitet.

- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave përmes kontratës “Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal” dhe kontratës aktive për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale do të shqyrton mundësinë e vendosjes së pahive elastike në segmente të caktuara me rrezikshmëri në këtë rrugë me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti eventual me theks gjatë stinës së dimrit.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!  
Me respekt,

  
Ramadush Osmani  
Drejtor i DSHPE-s